

## **UDHËZUES I THJESHTËSUAR PËR KONFISKIMIN NË KOSOVË**

Konfiskimi në Kosovë

Një udhëzues i thjeshtësuar për prokurorë

### **Tabela e përbajtjes**

Një udhëzues i thjeshtësuar për prokurorë .....	6
Zbatimi Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.....	7
Zbatimi Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin në rast të vdekjes etj.....	10
Konfiskimi i përsitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penale.....	10
Hetimet financiare rrith konfiskimit .....	13
Koordinimi i konfiskimit mes prokurorëve dhe hetuesve .....	15
Udhëzim per për planifikimin para sekuestritimit dhe caktimin e vlerës minimale të pasurive.....	18
Lista e kontrollit .....	21

## Konfiskimi i zgjeruar në Kosovë

### Një udhëzues i thjeshtësuar për prokurorë

Janë tri fusha të konfiskimeve që prokurorët duhet të marrin parasysh, së pari instrumentet (mjetet) e përdorura në kryerjen ose për parapërgatitjen e veprës penale, e dyta nëse gjendet ndonjë nga gjërat e ndaluara (armë, kontrabandë), së treti çfarëdo përfitimi penal që është identifikuar.

Në të gjitha rastet ju duhet të respektoni hapat e **identifikimit, sekuestrimit, konfiskimit**.

Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë i vitit 2018 ( ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2019 **Ligji nr. 06/L-087**) rregullon konfiskimin për instrumentet (mjetet) dhe përfitimet materiale nga krimet dhe përmban dispozita të reja që lehtësojnë sekuestrimin e aseteve dhe konfiskimin e tyre.

Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë i lejon një prokurori të kërkojë konfiskimin e aseteve edhe në situatat kur vdes i pandehuri, kur largohet nga jurisdiksioni (arratiset), kur është i paarritshëm ose jo prezent në Republikën e Kosovës, vuan nga një çrregullim ose paaftësi mendore ose kur ka pronë të pashpjegueshme me të ardhura legjitime.

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e krijuar me **Ligjin 03/L-141** ka përgjegjësinë për menaxhimin e këtyre aseteve të sekuestruara ose që iu janë nënshtuar konfiskimit të përkohshëm, që mund të jetë subjekt i konfiskimit pas dënimit të suksesshëm. Agjencia mund të administrojë vetëm asetat në 'qarkullim ligjor'. Prokuroria duhet të siguroj që asetat që i dërgohen nën kujdes agjencive, janë të shoqëruara me urdhrin për konfiskim të përkohshëm, për ndalim ose sekuestrim të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Ligji i vitit 2010 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit (**Ligji 03/L-196**) gjithashtu luan një rol. Vepra e shpëlarjes së parave është e përshkruar në nenin

32(2). Si dhe veprat (dhe veprat e tentuara) të konvertimit, transferit, fitimit, përdorimit (shfrytëzimit) të të ardhurave të krimit, dhe akti i mbajtjes së një prone të tillë është e mjaftueshme për të shkaktuar një vepër penale dhe rrjedhimisht prokurorët duhet të marrin parasysh rolin e palëve të treta të cilët mund te mbajnë pronën që është produkt i krimit dhe subjekt i konfiskimit dhe të marrin parasysh ta dërgojnë rastin tek PSRK-ja për hetim. Një i pandehur mund gjithashtu të ndiqet për shpëlarje të të ardhurave të tij të përfituar nga krimi (neni 32 (4)).

Ky udhëzues është nxjerrë duke marrë parasysh dokumentin ‘Rrugët e konfiskimit’ dhe është përshtatur me ndryshimet e reja ligjore të vitit 2019, si tek LKZK ashtu edhe tek Kodi Penal që ka hyrë poashtu në fuqi në vitin 2019. Dokumenti “Rrugët e konfiskimit” rekomandohet të lexohet nga të gjithë zbatuesit e ligjit dhe gjithashtu përmban shembuj të dobishëm të skenarëve praktik.

### Zbatimi Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë

1. LKZK mund të zbatohet vetëm pasiqë prokurori siguron një aktgjykim dënues për një të pandehur për veprat penale të parapara në nenin 2 të LKZK-së.

SHEMBULL: dy të pandehur akuzohen për veprën penale të grabitjes nga neni 317 i KPRK-së, me ç ‘rast të njëjtit kanë grabitur shumën prej 50,000.00 € të gatshme dhe me rastin e kryerjes së veprës penale kanë përdorur veturën Mercedes për të shkuar dhe për tu larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Ndërkohë gjykatat sjellin aktgjykim dënues e i cili bëhet i formës së prerë.

2. Pas marrjes së aktgjykimit dënues për njëren nga veprat penale si në nenin 2 të LKZK-së, prokurori duhet të sigurohet që të zhvillojë një hetim për konfiskimin duke shkuar deri brenda 10 viteve para ditës kur është iniciuar fazë hetimore për një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 të LKZK-së.

SHEMBULL: Vepra penale e grabitjes bën pjesë në veprat penale kundër pasurisë dhe njëkohësisht sipas nenit 2.1.13 dhe 2.1.16 të LKZK-së plotësohen kushtet që prokurori të kërkoj konfiskimin e zgjeruar. Andaj nëse hetimet kanë filluar ndaj dy të pandehurve si më lartë me dt. 22.10.2020, prokurori mund dhe duhet të hetoj nëse të pandehurit kanë krijuar pasuri që nga data 21.10.2010 e tutje. Pra pasuria e krijuar nga dy

të pandehurit që nga data 21.10.2010 e tutje mund të jetë subjekt i kërkesës për konfiskimin e zgjeruar.

3. Hetimi për konfiskimin mund të bëhet paralelisht edhe gjatë fazës së hetimeve penale, pas ngritjes së aktakuzës, para shqyrtimit gjyqësor, gjatë shqyrtimit kryesor, pas përmbylljes së shqyrtimit kryesor dhe brenda kufizimit kohor të përcaktuar në nenin 4 të LKZK-së e që i bie koha brenda periudhës 5 vjeçare pasi që aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

**SHEMBULL:** nëse aktgjykimi është i plotfuqishëm nga data 22.12.2020, prokurori mund të bëj hetimin për konfiskimin deri me dt. 21.12.2025. Pra sikur se shihet afati prej 30 ditëve në LKZK-në e vjetër është ndryshuar sepse ka qenë afat tepër i shkurtë ndërsa tash është afati prej 5 viteve që është afat i arsyeshëm dhe i mjaftueshëm. Megjithatë kjo nuk dmth se prokurori duhet të presë me komoditet afatin në fjalë, por në të vërtetë duhet të përpinqet që hetimi për konfiskimin të bëhet sa më parë që është e mundur.

4. Barra e të provuarit tek prokurori, pas aktgjykimit dënuar, do të ketë të bëj me: të paraqesë të gjitha pasuritë që janë objekt i verifikimit të pasurisë, të identifikojë në mënyrë të qartë të gjitha pasuritë, të ofroj prova që secila pjesë e pasurisë është pronë e të pandehurit.

**SHEMBULL:** hipotetikisht gjatë hetimit për konfiskimin, prokuroria zbulon se dy të pandehurit kanë krijuar pasuri, edhe atë: në vitin 2011 kanë blerë pasuri - banesë në Mal të Zi, në vitin 2014 kanë blerë hotel në Shqipëri, në vitin 2019 kanë blerë banesë në Serbi dhe në vitin 2018 e 2019 kanë blerë banesa dhe tokë në Prishtinë e Pejë.

Në këtë situatë prokurori duhet ti paraqesë në kërkesën për verifikim të pasurisë, të identifikojë qartë pasuritë si më lartë, psh. banesa në Prishtinë gjendet në lagjen "Luan Haradinaj", objekti I, hyrja II, nr. 14 dhe se pasuritë në fjalë janë pronë e të pandehurve.

5. Pas momentin sipas pikës 4 të këtij Udhëzimi, barra e të provuarit kalon në të pandehurin dhe ai duhet të provojë se pasuria e tij është fituar nga ai/ajo nga burimet e mjaftueshme legjitime që ka pasur në kohën kur e ka fituar pasurinë e tillë, nëse pasuria në fjalë është pasuri e transferuar nga një blerës bona fide apo nëse pasuria e kërkuar për konfiskim nuk është pronë e të pandehurit.

**SHEMBULL:** Që nga momenti si në pikën 4, është barra mbi të pandehurin të dëshmoj kriteret si në pikën 5, e kryesorja është që të dëshmoj ai e jo prokuroria, se pasuritë e krijuara janë bërë me burime legjitime të tij/tyre.

Pra i PANDEHURI duhet të dëshmoj se banesat si në shembullin në Mal të Zi, Shqipëri, Serbi e Kosovë janë blerë me burimet legjitime (psh ka pasur biznes legjitim dhe me qarkullim të lartë).

6. Është e detyrueshme që sendet e përdorura në kryerje të ndonjë veprimi në drejtim të veprës penale, dobisë pasurore apo dhuratës së njollosur apo përkufizimet më të sakta sipas nenit 19.1.39 të draft KPP-së duhet të konfiskohen.
7. Procedurat për konfiskimin e të ardhurave nga krimi/përfitimet kriminele trajtohen në seksionin që vijon, sidoqoftë prokurorët duhet të sjellin një vendim të hershëm për ç'do instrument që mund të jetë gjithashtu përfitim kriminel. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është themeluar për të administruar, menaxhuar dhe eventualisht të likuidojë përfitimet nga krimi, kur jepet urdhri nga gjykata. Agjencia nuk menaxhon sendet e ndaluara ose të kontrabanduara (Agjencia mund të menaxhojë vetëm asetet që janë 'në qarkullim ligjor') por ligji parashev që prokurori *mund* të kërkoj nga agjencia menaxhimin e pronës për ta ruajtur atë për konfiskim në përfundimin e procedurave.

**SHEMBULL:** Nëse subjekt i kérkesës për konfiskim janë sidomos veturat, telefonat apo çfarëdo pasurie tjetër e cila shpejtë humb vlerën, prokurori duhet të kujdeset të përfaqësojë më së miri interesin publik sipas nenit 49.1.1 dhe 269 e 269 të KPP-së dhe të kérkojnë shitjen e aseteve në fjalë.

8. Përpos urdhrale kufizues sipas neneve 8 dhe 9 të LKZK-së, prokurori duhet të mbajë mend dhe të veproj në rast se identifikon pasuri shtesë. Andaj ky Udhëzim përsërit se hetimi për konfiskimin zbatohet gjatë gjithë kohës, e përshkruar si më lartë, dhe apo të identifikojë pasuritë shtesë të të pandehurit zbaton nenet 9 dhe 11 të LKZK-së. Pra është obligim i hetuesisë dhe prokurorisë që gjatë gjithë kohës të bëhen hetime proaktive në drejtim të identifikimit të pasurive shtesë që nuk kanë mundur të identifikohen më herët.

LKZK NENET  
14, 15, 17

**SHEMBULL:** pavarësisht faktit se prokurori ka proceduar me LKZK-në dhe ka iniciuar kérkesën për verifikimin e pasurisë sipas nenit 4 të LKZK-së për pasurinë e të pandehurve në Mal të Zi, Shqipëri, Serbi e Kosovë, ndërkojë nëse prokurori sërisht identifikon pasuri tjetër të të pandehurve, kësaj radhe psh. në Turqi dhe Zvicër. Prokurori mund të filloj sërisht rishtazi, pa asnjë pengesë procedurale inicimin e kérkesës për verifikim të pasurisë që nga fillimi. Kuptohet që tash subjekt i kérkesës për verifikim të pasurisë, është pasuria e identifikuar e të pandehurve në Turqi dhe Zvicër, e cila pasuri duhet të jetë krijuar nga dt. 21.10.2010 e tutje.

LKZK neni 18

9. Në rast se gjatë hetimit për konfiskimin prokurori ballafaqohet me faktin se dëshmitë mund të jepen nga persona që në procedurën penale do të ishin të liruar nga dëshmimi, duhet të merret parasysh se në hetimin për konfiskimin një gjë e tillë nuk vlen. Pra prokurori mund dhe duhet që edhe ndaj personave të tillë të kërkoj që ata ti: përgjigjen pyetjeve menjëherë ose në një kohë dhe vend të specifikuar, dhënien e informacionit të specifikuar dhe sigurimin e dokumenteve ose dokumenteve përshkruar të specifikuara në njoftim. **Sidoqoftë, marrja e informatave nga persona të tillë, nuk mund të përdoret në procedurën penale kundër atij personi.**

**SHEMBULL:** Një person që sipas nenit 127 të KPP-së është i liruar nga dëshmimi në procedurë penale, NUK është i liruar nga dëshmimi në hetimin për konfiskim. Ai detyrohet të dëshmoj dhe madje nëse nuk dëshmon, mund të ndiqet dhe të dënohet për kryerje të veprës penale sipas nenit 18 të LKZK-së. Mirëpo duhet të mbahet në mend se asnje informacion ose material i siguruar nga personi i tillë, NUK do të jetë i pranueshëm nëasnje procedurë penale kundër atij personi (neni 18.9 i LKZK-së).

#### **Zbatimi Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin në rast të vdekjes etj.**

10. Prokurori duhet të mbaj mend dhe të veproj edhe në rast se ka iniciuar kërkesën për konfiskim, mirëpo që i pandehuri ndërkokë vdes, arratiset.

**SHEMBULL:** Në situatën kur kemi aktgjykimin dënuar ndaj dy të pandehurve për grabitje, mirëpo njëri apo të dy të pandehurit ndërkokë, ose vdesin, arratisen etj. kjo nuk paraqet asnje pengesë procedurale, sepse vlera e pasurisë së identifikuar në shembullin tonë kalon vlerën prej 10,000.00 € dhe paraqet interes të drejtësisë që të vazhdohet me procedurat, andaj edhe nëse të pandehurit vdesin apo janë të paarritshëm etj., procedura për konfiskimin sipas LKZK-së vazhdohet.

LKZK neni 19

Madje procedura për konfiskimin vazhdohet sipas nenit 19 të LKZK-së, edhe në situatën hipotetike kur prokurori ende nuk ka ngritur aktakuzën për grabitje kundër dy të pandehurve. Në këtë situatë, prokurori duhet të hartoje aktakuzën brenda afatit prej 180 ditësh (neni 19.7 i LKZK-së).

LKZK Neni 20

#### **Konfiskimi i përfitimit material ose të mjeteve për kryerjen e një vepre penale**

11. Prokurori duhet të mbaj mend dhe të veproj edhe në rast se ka iniciuar kërkesën për konfiskim, mirëpo që i pandehuri ndërkokë vdes, arratiset, është i paarritshëm ose jo prezent në Republikën e Kosovës apo vuani nga ndonjë çrregullim ose paaftësi mendore. Asnjëra nga shkaqet e lartpërmendura nuk përbën bazë ligjore që prokurori të ndaloj me kërkesën për konfiskim. Përkundrazi, LKZK jep bazë ligjore që procedura për konfiskim të vazhdojë, madje edhe atëherë kur ende nuk është ngritur aktakuzë. Mirëpo në rast të tillë, prokurori ka 180 ditë afat për të ngritur aktakuzën në fjalë, gjithmonë nëse vlera e pasurisë që është objekt i konfiskimit të zgjeruar kalon 10,000.00 € dhe është në interes të drejtësisë që të vazhdohet me procedurën e konfiskimit.

**SHEMBULL:** mund të ndodh që në rastin tonë të grabitjes, të pandehurit kanë shpenzuar shumën prej 50,000.00 € dhe ajo shumë më nuk është në dispozicion për tu konfiskuar. Poashtu edhe vetura Mercedez më nuk është në dispozicion për konfiskim.

Sipas nenit 20 të LKZK-së pavarësisht se ka pengesa procedurale për të vazhduar me gjykin penal kundër të pandehurve, NUK ka pengesa procedurale për të vazhduar me procedurën për konfiskim sipas LKZK-së, ngase vlera e pasurisë kalon vlerën prej 10,000.00 € dhe është në interes të drejtësisë të vazhdohet me procedurën e konfiskimit.

Dallimi mes nenit 19 dhe 20 të LKZK-së konsiston në faktin se nenii 19 flet për situatën kur zbatohet konfiskimi i zgjeruar i aseteve që NUK kanë të bëjnë me veprën penale (psh pasuria në Mal të Zi, Shqipëri, Serbi, Kosovë, Turqi e Zvicër), kurse nenii 20 i LKZK-së ka të bëj me situatën kur kërkohet konfiskimi i mjetit apo dobisë pasurore apo dhuratës së njollosur që lidhet drejtpërdrejtë me kryerjen e veprës penale (psh shuma prej 50,000.00 € plus Mercedezi).

Shembull: nenii 20. Dy persona kryejnë një grabitje në bankë dhe marrin nga banka 50,000.00 €. Me rastin e grabitjes përdorin një veturë Mercedez. Nenii 20 i LKZK-së lejon vazhdimin e procedurës së konfiskimit, nëse i pandehuri vdes apo nga ndonjë shkak i më sipër përmendur procedura penale nuk mund të vazhdohet kundër tij, qoftë edhe nëse nuk është ngritur aktakuza. Në këtë situatë, meqenëse vlera e pasurisë kalon shumën prej 10,000.00 € sipas nenit 20.4 të LKZK-së, prokurori duhet të propozoj vazhdimin e procedurës, vetëm sa i përket konfiskimit të shumës prej 50,000.00 € si dobi pasurore dhe vetrës së përdorur në kryerjen e veprës penale.

Ndërsa nenii 19 flet për situatën kur psh. në skenarin si më lart, të pandehurit akuzohen dhe ndaj tyre shqiptohet aktgjykim dënuar. Meqenëse grabitja është vepër penale sipas kapitullit XXVI të KPRK-së apo Veprat Penale kundër Pasurisë, përbushet me këtë edhe kriteri nga nenii 2.1.13 i KPRK-së por njëkohësisht edhe 2.1.16. Pra pas aktgjykimit dënuar,

prokurori mund të zbatoj hetimin për konfiskimin dhe nëse vërtetohen kriteret nga neni 4 i LKZK-së (të sinquruar si në pikën 4 dhe 5 të këtij Udhëzuesi) dhe identifikohen pasuri tjera të të pandehurit që NUK kanë të bëjnë me veprën penale të grabitjes, psh identifikohet pasuri në Mal të Zi, Shqipëri e Kosovë, prokurori duhet të kërkoj edhe konfiskimin e këtyre pasurive.

Bara e të provuarit më pas, bie në të pandehurit se ata me mjete legjitime kanë mundur ta krijojnë pasurinë në fjalë.

12. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim (LKZK) lejon konfiskimin e aseteve të transferuara tek pala e tretë nga personi i cili është ose bëhet një i pandehur ose person i dënuar, deri sa pala tjetër nuk ka qenë blerës bonafide (mirëbesim). Në rrethanat e tillë, prokurorët mund të kërkojnë që të merret parasysh referimi i palës së tretë tek PSRK-ja për hetim të shpëlarjes së parave.

LKZK neni  
3.1.4

13. Një prokuror/hetues ka një numër të mjeteve që do mund të përdoren për të identifikuar asetet që mund të konfiskohen;

- NJIF
- Informimi nga Agjencia kundër Korrupsionit
- Regjistrat e kontabilitetit dhe kompjuterët e konfiskuar nga bastisjet
- Regjistrat e pronës (Kadastrale)
- Regjistrat e xhirologarive bankare
- Mbikëqyrje e bërë para arrestimit mund të identifikojnë vetura/prona
- Pranimet e bëra gjatë intervistës
- Hetimet ndërkombëtare nëpërmjet rrjetit CARIN.

Prokurorët duhet të janë të ndërgjegjshëm që të mos tej-ngarkojnë NJIF-në dhe agjencitë tjera me numër të tepruar të kërkesave për informata.

14. Prokurori mund të caktojë një ekspert, eksperti mban një analizë financiare për të gjurmuar dhe identifikuar lëvizjet e përfitimeve materiale. Eksperti duhet të jetë në gjendje të bëj një

KPP neni. 137  
KPP neni. 138

përbledhje të aseteve, se si janë fituar ato dhe duhet të jetë në gjendje të informojë gjykatën që një aset duhet t'i nënshtronhet konfiskimit. Eksperti mund të jetë polic. | KPP nen. 148

## HETIMET FINANCIARE RRETH KONFISKIMIT

### I. Identifikimi i pasurive

Për të identifikuar pasuritë për konfiskim të mundshëm, duhet të kryhet hetim finanziar. Si pjesë e çdo hetimi finanziar, prokurorët dhe hetuesit duhet të punojnë së bashku për të:

1. identifikuar pasuritë që mund t'i nënshtronen konfiskimit;
2. përcaktuar bazën ligjore për konfiskim;
3. koordinuar me agjencinë e administrimit të pasurive (AAPSK);
4. përcaktuar pronësinë e pasurive;
5. përcaktuar vlerën neto të pasurive;
6. identifikuar dhe hetuar interesat e mundshëm të palëve të treta;
7. identifikuar viktimat e mundshme;
8. identifikuar dhe hetuar interesat e mundshëm të palëve të treta;
9. siguruar që akuzat penale të cekura në aktakuzë të ofrojnë bazë adekuate për konfiskim; dhe
10. përdorur urdhra penal për sekuestrim, për të ruajtur pasuritë para ngritjes së aktakuzës (sekuestrimi).

### II. Hetimet financiare janë kritike sepse:

- hetimet financiare sulmojnë shkakun thelbësor të veprimtarisë së paligjshme si dhe prishin, çmontojnë dhe shkatërrojnë organizatën kriminale
- Mund të ngriten raste më të thukëta kundër kryerësve
- Identifikohen pasuritë për sekuestrim dhe konfiskim para se ato të zhduken
- Merren shënimë në lidhje me blerjen, mbajtjen dhe pronësinë e pasurive.

### III. Procesi i Hetimeve Financiare

1. Marrja dhe vlerësimi i informacionit nga bazat e të dhënave të qeverisë/zbatuesve të ligjit.
2. Marrja dhe vlerësimi i informacionit nga llogaritë në internet dhe media sociale.
3. Marrja dhe vlerësimi i informacionit nga burimet publike.

4. Lëshimi i urdhrave të prokurorit/gjykatës për institucionet financiare dhe subjektet tjera dhe vlerësimi i informatave të kthyera.
5. Identifikimi dhe vlerësimi i pasurive të mundshme për konfiskim.
6. Kryerja e konsultimeve me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF) nëse ka të dhëna financiare ose pasuri jashtë vendit.
7. Kur konsiderohet e nevojshme, shfrytëzimi i kanaleve të komunikimit të Ministrisë së Drejtësisë (MD) për të paraqitur kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë (MLA) në vendet përkatëse ku pasuritë mund të gjenden.
8. Kryerja e intervistave financiare.
9. Organizimi i informacionit për rastin.

#### **IV. Pjetje për intervistën financiare**

- A keni ndonjë llogari në media sociale? Në cilat platforma?
- Çfarë pasurish posedoni (p.sh. makinë, tokë, shtëpi, anije, biznes, bizhuteri, vepra arti)? - Sa është vlera e tyre? - Ku gjenden ato? - Në emrin e kujt janë pasuritë (d.m.th., korporatave, të nominuarve)?
- Çfarë pasurish keni shitur në 10 vitet e fundit? - Sa para keni marrë?
- Çfarë pasurish domethënëse keni blerë në 10 vitet e fundit? (P.sh. përmbi \$ 10.000)?
- Kush është pronar i ndërtesës shtëpisë/apartamentit tuaj? - Sa është pagesa e qirasë/hipotekës?
- Ku janë llogaritë tuaja bankare? – Çfarë depozitash keni bërë në llogaritë tuaja? – A keni ndonjë llogari në banka të huaja?
- Çfarë shpenzimesh keni?
- Çfarë borxhesh/kredish keni? - Kujt i keni borxh? - Sa nga ky borxh e paguani çdo muaj?
- A mbani shënime financiare? - Kush i mban ato shënime? - Ku mbahen ato?
- Cila është shuma më e madhe e parave të gatshme që keni pasur ndonjëherë në posedimin tuaj (jo në në llogari bankare) (d.m.th., të ruajtura në kasafortë, te ndonjë mik, të futura nën dhe, nën jastëk)? - Cili ka qenë shkak që ju keni pas kaq shumë para? Kur ka qenë kjo? - Kush kishte njohuri për këtë? - Çka keni bërë me to?
  - Çfarë burimesh të të ardhurave keni?
  - A keni pranuar para nga: aftësia e kufizuar, mirëqenia sociale, huatë, marrëveshjet e sigurimeve, shitja e pasurive, shtesat e fëmijëve, lojërat e fatit, të ardhurat nga qiraja, trashëgimia ose dhuratat monetare?
  - Sa para keni marrë? - Nga kush i keni marrë? - Çka keni bërë me ato para?
  - Sa janë të ardhurat nga punësimi i juaj?
  - Ku punoni?
  - Sa kohë ka që punoni aty?
  - Si quhet shefit i juaj?
  - Sa paguani në javë?
  - Si paguheni?
  - Si i shpenzoni të ardhurat tuaja?
  - Kur është hera e fundit që keni paraqitur kërkesë për kthim të tatimit?

- Kush e ka përgatitur atë (emri dhe adresa)?
- Sa të ardhura i keni raportuar?

## **Koordinimi i konfiskimit mes prokurorëve dhe hetuesve**

### **I. Bëjeni konfiskimin pjesë rutinore të çdo rasti penal, veçanërisht atyre që përfshijnë viktima**

Kryeni hetim finansiar të hershëm dhe efektiv. Prokurori dhe hetuesi duhet të koordinojnë përpjekjet për të siguruar që të marrin të gjithë hapat e nevojshëm hetimor për të çuar në maksimum konfiskimin e pasurive.

Ekipi hetimor duhet të koordinohet - si para ashtu edhe pas aktakuzës - për ta përfunduar hetimin finansiar, për t'i identifikuar dhe komunikuar me viktimat, për të llogaritur dhe provuar shumat e humbjes dhe dëmshpérblimit, për të identifikuar pasuritë, gjurmuar të ardhurat nga veprat penale dhe pasuritë, për të konfiskuar pasuritë dhe siguruar që të ardhurat nga pasuritë e konfiskuara t'u paguhen viktimate si dëmshpérblim.

Krijoni pritshmëri që hetuesit (me ndihmën e prokurorit) të kryejnë ato lloje të hetimeve që janë të nevojshme për të çuar në maksimum konfiskimin e pasurive.

### **II. Qëllimet e hetimeve të konfiskimit të pasurive**

- A. Identifikimi i veprës penale dhe kush e ka kryer atë;
- B. Identifikimi i viktimate të krimít dhe humbjeve të tyre;
- C. Identifikimi i pasurive që i nënshtrohen konfiskimit ose që mund të jenë në dispozicion si pasuri zëvendësuese; dhe
- D. Marrja e hapave sa më shpejt të jetë e mundur për të ruajtur pasuritë për konfiskim (urdhra sekuestrimi/kufizimi).

### **III. Hapat që duhet të ndërmerren nga prokurori dhe hetuesi gjatë hetimit penal për të çuar në maksimum konfiskimin e pasurive**

- A. Përdorimi i deklaratës së dëmeve dhe faturave të siguruara nga viktima për të identifikuar humbjet e viktimate. Përdorimi i të dhënave publike për të identifikuar pasuritë e shënjestruara dhe për të gjurmuar të ardhurat nga vepra penale nën hetim dhe pasuritë.

**B. Përdorimi i procedurave ligjore/urdhrale/thirrjeve dhe mjeteve tjera për të identifikuar viktimat, humbjet e viktimateve, pasuritë e shënjestrës dhe për të gjurmuar të ardhurat nga vepra penale nën hetim dhe pasuritë.**

- Gjurmimi i të ardhurave kriminale dhe pasurive ndihmon në çuarjen në maksimum të konfiskimit të pasurive duke: (1) ju mundësuar që të sekuestroni apo kufizoni të ardhurat në procedurën paraprake dhe të parandaloni zhdukjen e tyre, dhe (2) mbrojtur të ardhurat e gjurmua nga pretendimet e palëve të treta.

**C. Prokurori dhe hetuesi duhet të kryejnë planifikimin para konfiskimit për të përcaktuar se cilat nga pasuritë e shënjestrës ia vlen të ndiqen.**

1. Merrni të dhëna të pronës/titullarit për pasurinë e paluajtshme të personit të shënjestruar për të përcaktuar (a) nëse ai është pronari; dhe (b) kapitalin neto të personit të shënjestruar.
2. Përcaktoni kapitalin neto të personit të shënjestruar të automjeteve dhe pasurive tjera potencialisht të konfiskueshme që mund të kenë barrë.
3. Përcaktoni strukturën e biznesit/korporatës dhe pagesat e përfitimet për të përcaktuar transaksionet mashtruese të bëra për përfitime të palëve të treta, siç janë miqtë dhe anëtarët e familjes.
4. Njiheni të pandehurin tuaj dhe njihjani familjen. Të pandehurit shpesh ua transferojnë pronësinë anëtarëve të familjes duke përdorur emrat e tyre. Hetuesit duhet të kryejnë kërkime të pasurive duke përdorur pseudonimet e të pandehurit dhe emrat e njohur të familjarëve.

**D. Rishikoni provat dhe diskutoni nëse ndonjë pasuri i nënshtronhet konfiskimit si mjet i kryerjes së veprës penale (instrumentalitet).**

1. Përcaktoni nëse një pronë e luajtshme apo e paluajtshme është përdorur për ta lehtësuar veprën penale?
2. Nëse po duhet të analizohet nëse:
  - a. Ekziston "lidhje thelbësore me veprën penale" e tillë që po të mos ishte pasuria/prona lehtësuese vepra nuk do të ishte kryer ose nuk do të ishte kryer aq lehtë.
  - b. Shikojeni vlerën e pasurisë kundrejt dëmit të shkaktuar nga vepra penale për të konkluduar nëse sekuestrimi/konfiskimi i pasurisë do të ishte proporcional.

**E. Përcaktoni metodën më efikase dhe të përshtatshme për konfiskimin/kufizimin/sekuestrimin e pasurive para shpalljes fajtor.**

**F. Përgatitni me kohë dhe kërkonit urdhra për ngrirje/sekuestrim/kufizim.**

1. Prokurori (dhe koordinatori i konfiskimit nëse është i nevojshëm dhe i disponueshëm) duhet të punojë me hetuesin për të përgatitur kërkësë që krijon probabilitet të shëndoshë/dyshim të bazuar për të besuar se personi i shënjestruar

ka kryer vepër penale që lejon konfiskimin dhe përcakton lidhjen e duhur midis veprës penale dhe pasurisë.

2. Koordinoni ekzekutimin e urdhrit të sekuestrimit/kufizimit për ta parandaluar shënjestrën që të zhduk pasuritë pasi që hetimi të bëhet i ditur.

G. Hetuesi duhet të përgatisë raport që identifikon çdo viktimë të krimit dhe humbjet e tyre, pasuritë e gjurmueshme të veprës dhe pasuritë e tjera të të pandehurit që mund të merren si pasuri zëvendësuese.

H. Nëse i pandehuri bie dakord të pranojë fajësinë, kërkoni nga ai që të bie dakord për zbulimin e pasurive dhe të dakordohet që të mos i zhdukë pasuritë në pritje të konfiskimit përfundimtar. I pandehuri gjithashtu duhet të pranojë të dorëzojë të gjitha pasuritë kryesore.

#### IV. Hapat që mund të bëjë prokurorë për ta ndihmuar hetuesin

- A. Cakton takim herët në proces me hetuesin (dhe koordinatorin e konfiskimit nëse ekziston dhe nevojitet) për të diskutuar strategjinë e konfiskimit të pasurive në rast.
- B. I jep këshilla hetuesit në lidhje me ligjet e konfiskimit dhe diskuton hapat për të marrë provat e nevojshme për të mbështetur kërkësat/urdhrat e sekuestrimit/kufizimit efektiv.
- C. Koordinon dhe komunikoni me personelin e AAPSK-së për çdo çështje të planifikimit para sekuestrimit - të tillë si përgatitjet për ruajtjen ose mirëmbajtjen e pasurive pas sekuestrimit ose nevojën për shitje të pasurive që mund të humbin vlerën.

## **UDHËZIM**

për planifikimin para sekuestrimit dhe caktimin e vlerës minimale të pasurive

### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të shërbejë si udhëzim për të gjitha prokuroritë themelore mbi nevojën për planifikim dhe vlerësim para konfiskimit që duhet të bëhet në secilin rast kur duhet sekuestruar dhe konfiskuar pasuritë e paligjshme. Ky udhëzim nuk zbatohet për sendet që i nënshtrohen konfiskimit automatik.

### **Planifikimi para konfiskimit**

Planifikimi para sekuestrimit është pjesë e rëndësishme e rastit të konfiskimit të pasurive. Qëllimi i planifikimit para konfiskimit është të ndihmojë në parashikimin dhe marrjen e vendimeve të informuara në lidhje me:

- llojin e pasurisë që do të sekuestrohet?
- si dhe kur do të sekuestrohet? dhe më e rëndësishmja,
- nëse duhet të sekuestrohet?

Koha e planifikimit që kërkohet mund të jetë e shkurtër ose mund të kërkoj disa ditë, madje edhe javë, për të marrë informacionin e nevojshëm për t'u përgatitur për konfiskimin. Duhet të jetë pjesë e hetimit të rastit. Do të ishte ideale që prokurorët të përcaktojnë qysh në fillim të hetimit, para sekuestrimit, nëse një pasuri ia vlen të sekuestrohet dhe konfiskohet duke marrë parasysh:

- gjendjen aktuale të pasurisë dhe vlerën aktuale të vlerësuar;
- vlerën e parashikuar pas konfiskimit përfundimtar dhe shitjes; dhe
- çdo kosto të ruajtjes ose mirëmbajtjes.

Gjatë përcaktimit nëse një pasuri e caktuar duhet konfiskuar, prokurori duhet të bëjë dallimin nëse pasuria është:

- **Provë** - në këtë rast pasuria konfiskohet dhe mund të asgjësohet/shitet në fund të procedurave.
- **Mjet i kryerjes së veprës penale/Instrumentaliti** Nëse pasuria është përdorur për të lehtësuar kryerjen e veprës penale (si instrumentalitet), do të zbatohet parimi i proporcionalitetit. Të drejtat e palëve të treta duhet të merren parasysh në çdo kohë.
- **Dobia pasurore e veprës penale** sekuestrohet duke pasur parasysh vlerën e saj dhe të drejtat e palës së tretë.
- **Dhurata e njollosur** - konfiskohet nëse plotësohen kushtet sipas ligjit.

Prokurori i rastit koordinohet me agjencinë e zbatimit të ligjit që ka hetuar rastin dhe Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPS). Ky koordinim duhet të përfshijë takimin mes hetuesve të rastit dhe AAPS-së ose agjencive të tjera të përfshira në sekuestrim. Veprimet e planifikimit të para konfiskimit që kërkohen të ndërmerrin nga prokurori i rastit, përvèç përcaktimit të vlerës së parashikuar, përfshijnë gjithashtu veprime që duhen ndërmarrë për marrjen e të gjitha informacioneve rrëth pronësë ose titullit pronësor. Prokurori duhet të bëjë hulumtim rrëth titullit pronësor për çdo pasuri të paluajtshme nëse një hulumtim i tillë i titullit nuk është kërkuar tashmë. Nëse pasuria është automjet, prokurori duhet të kërkojë që hetuesi të marrin dokumentin e regjistrimit të automjetit. Në përcaktimin e vlerës së pasurisë duhet të merret parasysh çdo hipotekë e njojur.

*Nëse vlerësimi zbulon se sekuestrimi i pasurisë do të rezultojë në barrë për Qeverinë, prokurori duhet të merr parasysh që të mos e bëjë fare sekuestrimin/konfiskimin. Sidogoftë, konfiskimi do të merret parasysh edhe në rastet e pasurive që kanë vlerë minimale nëse ekzistojnë rrëthana të veçanta rënduese ose nëse sekuestrimi ose konfiskimi është në interes të drejtësisë.*

Për ta përcaktuar vlerën neto të pasurive:

- koordinohuni me AAPS-në në lidhje me vlerën neto të secilës pasuri;
- për prona të paluajtshme, hulumtoni nëse ka ndonjë hipotekë.

Kini kujdes nga pasuritë që krijojnë probleme të vështira ose të pazakonta:

- pasuritë ndërkombëtare;
- varkat;
- kafshët ose sendet që prishen;
- substancat kimike dhe farmaceutike;
- prona intelektuale;
- arti me vlerë dhe sendet antike;
- Pronat e kontaminuara;
- Bizneset funksionale.

### Sekuestrimi/Konfiskimi i automjeteve

Në mënyrë që një automjet të konfiskohet, prokurori duhet të përpiqet të marrë informacion mbi gjendjen aktuale të automjeteve. Ekzistimi i automjeteve të shumta me mundësi të sekuestrimit në të njëjtën kohë, kur automjetet e tillë janë në gjendje shumë të keqe mekanike, nuk duhet të shërbejë si arsyé për të vazhduar me sekuestrimin, nëse vlera e parashikuar për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shpenzimet e tjera administrative pritet të tejkalojë vlerën e automjeteve. Përjashtim nga ky rregull është kur automjetet janë modifikuar ose përshtatur për t'u përdor për veprimitari të paligjshme si: kontrabandimi i të huajve ose narkotikëve, ose lehtësimi i veprimitarive tjera të paligjshme.

### Makinat me qira

Rregulli i përgjithshëm është që makinat me qira nuk duhet të sekuestrohen ose të ndiqen për konfiskim. Kjo sepse i pandehuri nuk është pronar i automjetit. I pandehuri thjesht e posedon

përkohejësht atë gjatë kryerjes së veprës penale. Në shumicën e rasteve, pronari i vërtetë (kompania e makinave me qira) nuk ka njohuri se makina do të përdoret për të kryer vepër penale. Prokurori duhet të sigurohet që të respektohen dispozitat e KPP-së në lidhje me interesin e palës së tretë dhe në parim kompania e makinave me qira do ta fitonte rastin si *pronar i pafajshëm* në procedurat e konfiskimit dhe makina do t'i kthehej atij.

Ka përjashtime të tilla si ato kur pronari i kompanisë se makinave me qira e di ose duhej ta dinte, bazuar në faktet dhe provat e qarta, që makina do të përdorej për të kryer vepër penale. Kjo do të kërkojë hetime të mëtejshme. Për shembull, mund të ketë situata kur pronari i kompanisë së makinave me qira është mik i ngushtë me të pandehurin dhe e dinte që i pandehuri kishte kryer vepra penale të asaj natyre (të tilla si kontrabanda ose transporti i drogës) duke përdorur makinat me qira. Nëse ka indikacione mbi implikimet e mundshme të kompanive të makinave me qira në aktivitete të paligjshme, duhet të bëhen përpjekje për të zgjeruar hetimin për t'i përfshirë edhe këto kompani.

Nëse prokurorët vërejnë se të njëjtat kompani të makinave me qira përdoren në mënyrë rastësore për aktivitete të tilla të paligjshme, por nuk ka informacion të qartë se kompanitë janë të përfshira në këto aktivitete, mund të bëhet një përpjekje shtesë për të kontaktuar kompanitë e makinave me qira në atë zonë për t'i këshilluar ato që prokuroria e ka vërejtur një rritje të këtij aktiviteti dhe se duhet të bëhet kujdes shtesë nga kompanitë e makinave me qira kur japid makinat me qira.

<b>LISTË KONTROLI PËR KONFISKIM</b>		<b>Nr.rastit:</b>	
<b>Për të ndihmuar prokurorin e çështjes në harmonizimin e praktikës dhe raportimin e drejtë rrëth sekuestrimit/konfiskimit</b>			
<b>Detyra</b>		<b>Kryer</b>	<b>Datë</b>
<b>Planifikimi para sekuestrimit- Para ngritjes se aktakuzës Patundshmëritë (sigurimi i dokumenteve të pronësisë/posedimit)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Identifimi i aseteve për sekuestrim/konfiskim në lëndën penale (Në rast sekuestrimi të aseteve në raste komplekse, jepni Koordinatorit për konfiskim një listë të detajuar (përshtatmin e asetit, nr.serik, numri i shasisë nëse është veturë etj.)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Shënoni llojin e asetit (a është provë, instrumentalitet, dobi pasurore apo aset i njollisor)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Kërkesa për Urdhrin ndalues (Në raste më komplekse kur keni të bëni edhe me sekuestrim/konfiskim, konsultohuni sipas nevojës me Koordinatorin)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Aktakuza – përfshini të gjitha asetet e njohura në aktakuzë dhe jepni arsyetim përfshirjen e tyre (Në raste më komplekse kur keni të bëni edhe me sekuestrim/konfiskim, konsultohuni sipas nevojës me Koordinatorin)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Data e seancës/shqyrftimit gjyqësor ku shqyrtohet edhe sekuestrimi/konfiskimi (për raste më komplekse njoftoni edhe Koordinatorin për konfiskim)</b>			
<b>Shënim:</b>			
<b>Pranimi i fajësisë/Marrëveshja për pranimin e fajësisë – Listoni të gjitha asetet që duhen konfiskuar në Marrëveshje në raste më komplekse merrni edhe pëlgimin e Koordinatorit para finalizimit të Marrëveshjes</b>			

<b>Pas arritjes së Marrëveshjes siguroni një kopje për Koordinatorin.</b>		
<b>Shënim:</b>		
<b>Sanksionimi:</b> Mos harroni të përmendni në Fjalën tuaj përfundimtare edhe qëndrimin e prokurorisë lidhur me Konfiskimin dhe arsyetimin për të.		
<b>Shënim:</b>		
<b>Pas marrjes së vendimit nga ana e gjuqtarit, shikoni të gjitha pilket që lidhen me konfiskimin për tu siguruar që sipas nevojës në ankesë të parashfrohet edhe çështja e konfiskimit</b>		
<b>Shënim:</b>		